



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS  
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA  
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

# Metodika mbi Statistikat e Bilancit të Pagesave

V e r z i o n i 2 . 0



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS  
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA  
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

# **Metodika mbi Statistikat e Bilancit të Pagesave**

**BOTUES**

© Banka Qendrore e Republikës së Kosovës  
33 Garibaldi, Prishtinë 10000  
Tel: ++381 38 222 243  
Fax: ++381 38 243 763

**FAQJA E INTERNETIT**

[www.bqk-kos.org](http://www.bqk-kos.org)

**ADRESA ELEKTRONIKE**

[statistics@bqk-kos.org](mailto:statistics@bqk-kos.org)

## PËRMBAJTJA

|  |          |
|--|----------|
| <b>1. Baza ligjore për përpilimin e Bilancit të Pagesave</b>     | <b>5</b> |
| <b>2. Parimet e përgjithshme të Bilancit të Pagesave</b>         | <b>5</b> |
| 2.1 Statistikat e Bilancit të Pagesave                           | 5        |
| 2.2 Kriteri i rezidencës   | 6        |
| 2.2.1 Trajtimi i UNMIK-ut/EULEX-it                               | 6        |
| 2.2.2 Trajtimi i KFOR-it   | 7        |
| 2.2.3 Trajtimi i stafit tjetër ndërkombëtar                      | 7        |
| 2.3 Burimi i të dhënave  | 8        |
| 2.4 Periodiciteti  | 8        |
| <b>3. Zërat specifik të BP-së</b>                                | <b>8</b> |
| 3.1 Llogaria Rrjedhëse   | 8        |
| 3.1.1 Mallrat  | 8        |
| 3.1.1.1 Dallimet në mes të statistikave të BP-së dhe STJ-së      | 9        |
| 3.1.1.2 Korrigjimet në të dhënat bazike në kategorinë e mallrave | 11       |
| 3.1.2 Shërbimet  | 14       |
| 3.1.2.1 Shërbime transporti                                      | 14       |
| 3.1.2.2 Shërbime udhëtimi  | 15       |
| 3.1.2.3 Shërbime komunikacioni                                   | 15       |
| 3.1.2.4 Shërbime ndërtimi  | 15       |
| 3.1.2.5 Shërbime sigurimi  | 16       |
| 3.1.2.6 Shërbime financiare                                      | 16       |
| 3.1.2.7 Shërbime kompjuteri dhe informacioni                     | 16       |
| 3.1.2.8 E drejta e autorit dhe licenca                           | 16       |
| 3.1.2.9 Shërbime të tjera biznesi                                | 16       |
| 3.1.2.10 Shërbime personale, kulturore dhe argëtimi              | 16       |
| 3.1.2.11 Shërbime qeveritare                                     | 17       |
| 3.1.3 Të ardhurat  | 17       |
| 3.1.3.1 Kompensimi i punonjësve                                  | 17       |
| 3.1.3.2 Të ardhurat nga investimet                               | 17       |
| 3.1.4 Transferet rrjedhëse                                       | 17       |
| 3.1.4.1 Transferet rrjedhëse të sektorit qeveritar               | 18       |
| 3.1.4.2 Transferet rrjedhëse të sektorëve tjerë                  | 18       |
| 3.2 Llogaria kapitale dhe financiare e BP-së                     | 19       |
| 3.2.1 Llogaria kapitale  | 19       |
| 3.2.1.1 Transferet kapitale                                      | 19       |

|   |           |
|---|-----------|
| 3.2.1.2 Përvetësimi/asgjësimi i mjeteve joprodhuese-jofinanciare -----      | 20        |
| 3.2.2 Llogaria financiare -----   | 20        |
| 3.2.2.1 Investimet direkte-----   | 20        |
| 3.2.2.2 Investimet e portofolit-----  | 21        |
| 3.2.2.3 Investimet tjera -----  | 21        |
| 3.2.2.4 Asetet rezervë-----   | 21        |
| 3.3 Gabimet dhe Harresat Neto -----   | 22        |
| <b>4. Bilanci i Pagesave dhe Pozicioni Ndërkombëtar i Investimeve -----</b> | <b>22</b> |

## 1. Baza ligjore për përpilimin e bilancit të pagesave

Përpilimi dhe publikimi i statistikave mbi Bilancin e Pagesave (BP) të Kosovës është përgjegjësi e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK). Përgatitja e BP-së nënkupton grumbullimin e të dhënave nga burime të ndryshme përfshirë agjencitë qeveritare, sektorin financiar (BQK-në, bankat komerciale, kompanitë e sigurimeve, fondet pensionale, institucionet mikrofinanciare, etj), raportimet direkte nga kompanitë e mëdha jofinanciare, organizatat ndërkombëtare në Kosovë, etj. Përpilimi i BP-së bëhet konform standardeve ndërkombëtare siç janë: *Manuali mbi Bilancin e Pagesave* (BPM5), *Udhëzuesi për përpilimin e Bilancin e Pagesave* (anglisht “the Guide” – botuar më 1995 si dokument shoqëruar i Manualit BPM5), *Manuali mbi Bilancin e Pagesave dhe Pozicionin Ndërkombëtar të Investimeve* (BPM6), *Sistemi i Llogarive Kombëtare* (SNA 93), *Definicionet Standarde të OECD për Investimet e Huaja Direkte* (BD4), *Sistemi Evropian i Llogarive Kombëtare dhe Regjionale* (ESA 95), si dhe praktikatat e vendeve tjera.

## 2. Parimet e përgjithshme të bilancit të pagesave

### 2.1. Statistikat e bilancit të pagesave

Bilanci i pagesave paraqet informacion kyç ekonomik që përmbledhë në mënyrë sistematike transaksionet ekonomike të rezidentëve të Kosovës me botën e jashtme (jo-rezidentët), për një periudhë specifike kohore. Transaksionet ekonomike mund të jenë transaksione hyrëse (pranime) dhe transaksione të dalëse (pagesa). Pranimet nga jashtë janë të regjistruara në anën ‘kredi’ dhe përfshijnë eksportin e mallrave, eksportin e shërbimeve, fluksin hyrës të të ardhurave, të hyrat financiare si dhe transaksionet tjera hyrëse. Në anën tjetër, pagesat nga ana e rezidentëve ndaj botës së jashtme (jo rezidentëve) regjistrohen si ‘debi’ dhe përfshijnë importin e mallrave, importin e shërbimeve, fluksi dalës të të ardhurave, fluksi dalës financiar dhe transferet dalëse.

Në mënyrë konceptuale, një transaksion ekonomik i ka dy anë: diçka me vlerë ekonomike jepet dhe diçka me vlerë të njëjtë merret nëpërmes të sistemit të regjistrimit të dyfishtë. Kur jepet një vlerë ekonomike, (p.sh. eksporti) regjistrohet një vlerë në anën ‘kredi’, ndërsa kur një vlerë ekonomike merret (p.sh. importi) regjistrohet në ‘debi’. Kur diçka me vlerë ekonomike merret pa ndonjë kompenzim përkatës si këmbim, sistemi i regjistrimit të dyfishtë kërkon një shlyerje si input (regjistrim në kuadër të transfereve rrjedhëse apo kapitale) me vlerë ekuivalente. Si shembull tipik mund të shërbejë importi humanitar që kërkon së pari regjistrimin e vlerës mallit në debi si import, ku më pastaj e njëjta vlerë regjistrohet në kuadër të transfereve si kredi, në mënyrë që efekti financiar në statistikën e bilancit të pagesave të jenë të balancuara. Shembulli i mëposhtëm ilustron se si aplikohet sistemi i regjistrimit të dyfishtë:

| Hyrjet në kredi  | Hyrjet në debi  |
|--|---|
| Ndryshimet në të gjitha resurset ekonomike të ofruara nga kosovarët tek jorezidentët, duke përfshirë:  | Ndryshimet në të gjitha resurset ekonomike të marra nga kosovarët prej jorezidentët, duke përfshirë:  |
| <ul style="list-style-type: none"> <li>- Eksportin e mallrave dhe shërbimeve</li> <li>- Të ardhurat e pranuar</li> <li>- Transfertat të cilat shlyhen me hyrjet në debi</li> <li>- Detyrimet financiare të Kosovës tek jorezidentët</li> </ul> | <ul style="list-style-type: none"> <li>- Importi i mallrave dhe shërbimeve</li> <li>- Të ardhurat e paguara</li> <li>- Transfertat të cilat shlyhen me hyrjet në kredi</li> <li>- Pretendimet financiare të Kosovës tek jorezidentët</li> </ul> |

## 2.2. Kriteri i rezidencës

Rezidentët e Kosovës janë subjektet ligjore që janë të regjistruar dhe që veprojnë në Kosovë dhe personat fizik vendbanimi i të cilëve gjendet në Kosovë dhe të cilët nuk largohen nga Kosova për periudhë më të gjatë se një vit (përveç diplomatëve, studentëve dhe pacientëve mjekësor). Për shkak të specifikës, një theks i veçantë i është dhënë (a) trajtimit të UNMIK-ut dhe EULEX-it, (b) KFOR-it, dhe (c) stafit tjetër ndërkombëtar në Kosovë.

### 2.2.1 Trajtimi i UNMIK-ut/EULEX-it

Trajtimi statistikor i organizatave ndërkombëtare është çështje që është e definuar në standardet ndërkombëtare. Megjithatë, në rastin e Kosovës, bazuar në funksionet që kryejnë UNMIK-u e EULEX-i në Kosovë, këto dy institucione është vështirë të klasifikohen në kuptimin e plotë të fjalës si organizata ndërkombëtare. Prandaj, i është kushtuar vëmendje e posaçme trajtimit statistikor të tyre. Si hap i parë në këtë drejtim është bërë dallimi ndërmjet UNMIK-ut/EULEX-it si institucion si dhe stafit:

- UNMIK-u dhe EULEX-i si institucione janë trajtuar si jorezident të Kosovës;
- Rezidenca e stafit ndërkombëtar të UNMIK-ut dhe EULEX-it përcaktohet në baza të kohëzgjatjes së qëndrimit të tyre në Kosovë:
  - Stafi ndërkombëtar i UNMIK-ut/EULEX-it me kontratë mbi njëvjeçare trajtohen si rezidentë të Kosovës (më tej i quajtur 'stafi ndërkombëtar rezident');
  - Stafi ndërkombëtar i UNMIK-ut/EULEX-it me kontratë më të shkurtër se një vit trajtohen si jorezidentë të Kosovës (më tej i quajtur 'stafi ndërkombëtar jorezident').

Trajtimi statistikor i këtyre institucioneve bazohet në supozimet si vijon:

- Shpenzimet e UNMIK-ut/EULEX-it (si institucion) për blerjen e mallrave dhe shërbimeve në Kosovë, konsiderohen si eksporte të Kosovës (eksporte të shërbimeve qeveritare).
- Shpenzimet e UNMIK-ut/EULEX-it për pagat e stafit (lokal dhe ndërkombëtar) konsiderohen si asistencë teknike (grant) dhënë qeverisë së Kosovës (transfere rrjedhëse) nga organizatat ndërkombëtare.
  - Stafi rezident ndërkombëtar (me kontratë 'një vjeçare e më të gjatë') i UNMIK-ut/EULEX-it vlerësohet se shpenzojnë rreth 14% të pagave të tyre në Kosovë, 76% të tjera dërgohet në vendet e tyre (remitanca) kurse 10% shpenzohet për të udhëtuar jashtë vendi (shërbime udhëtimi/debi);
  - Stafi jorezident ndërkombëtar i UNMIK-ut/EULEX-it (me kontratë më pak se një vjeçare), vlerësohet se shpenzojnë rreth 14% të pagës së tyre në Kosovë (shërbime udhëtimi/kredi). Shuma e mjeteve të dedikuara për pagat e stafit jorezident ndërkombëtar regjistrohen në anën e debisë të llogarisë 'shërbime tjera biznesore'.

Bazuar në supozimet e cekura më lartë, përmes një shembulli hipotetik është paraqitur implikimi i UNMIK-ut/EULEX-it në BP-në e Kosovës:



Duke supozuar që buxheti i UNMIK-ut/EULEX-it është 100, struktura e shpenzimeve supozohet të jetë si vijon:

|  |          |
|--|----------|
| Pagat e stafit ndërkombëtar            | 63       |
| Stafi ndërkombëtar rezident            | 60       |
| Stafi ndërkombëtar jorezident          | 3        |
| Pagat e stafit lokal                   | 17       |
| Mallrat e importuara                   | 8        |
| Mallrat e blera në Kosovë              | 2        |
| Shërbimet e importuara                 | 6        |
| <u>Shërbimet e blera në Kosovë</u>     | <u>4</u> |
| Totali i buxhetit të UNMIK-ut/EULEX-it | 100      |

Atëherë, duke aplikuar këtë shembull në sistemin e regjistrimit të dyfishtë, regjistrimet në BP do të jenë si më poshtë:

#### Shembull hipotetik: Implikimi i UNMIK-ut/EULEX-it në BP

| Llogaria rrjedhëse  | Kredi       | Debi        |
|---|-------------|-------------|
| Shërbimet e udhëtimit   |             |             |
| Shp. në Kosovë të stafit ndërkombëtar jorezident (14%*3)            | 0.4         |             |
| Shp. e stafit ndërkombëtar rezident për të udhëtuar jashtë (10%*60) |             | 6.0         |
| Shërbimet e tjera biznesore   |             |             |
| Pagat e stafit ndërkombëtar jorezident                              |             | 3.0         |
| Shërbimet qeveritare  |             |             |
| Shpenzimet për Mallra dhe Shërbime lokale (2+4)                     | 6.0         |             |
| Transferet rrjedhëse  |             |             |
| Totali i pagave (63+17)   | 80.0        |             |
| Dërgesat e emigrantëve (76%*60)                                     |             | 45.6        |
| <b>Impakti në llogarinë rrjedhëse</b>                               | <b>86.4</b> | <b>54.6</b> |

Për shkak të trajtimit të lartpërmendur të UNMIK-ut/EULEX-it, shpenzimet për importimin e mallrave dhe shërbimeve, përveç atyre që blihen në Kosovë, konsiderohen si transaksione ndërmjet jorezidentëve, prandaj nuk paraqiten në BP.

#### 2.2.2 Trajtimi i KFOR-it

KFOR është forcë ndërkombëtare që udhëhiqet nga NATO-ja dhe që është përgjegjës për krijimin e një mjedisi të sigurt në Kosovë. KFOR ka hyrë në Kosovë më 12 qershor 1999 me një mandat të Kombeve të Bashkuara. Është kontingjent ushtarak dhe si i tillë është jorezident i Kosovës.

#### 2.2.3 Trajtimi i stafit tjetër ndërkombëtar

Konform standardeve ndërkombëtare stafi ndërkombëtar në Kosovë (përveç stafit të UNMIK-ut dhe EULEX-it) i angazhuar në ofrimin e ndihmës teknike apo aktiviteteve tjera në të mirë të institucioneve të Kosovës, trajtohet në bazë të kohëzgjatjes së qëndrimit të

tyre. Sidoqoftë, stafi ndërkombëtar i ambasadave dhe zyra të tjera të organizatave tjera në Kosovë (diplomatët, personeli ushtarak, dhe punëtorët tjerë të organizatave të tilla si dhe anëtarët e familjeve të tyre, të cilët banojnë në Kosovë dhe gëzojnë imunitetin dhe privilegjet diplomatike) trajtohen si jorezidentë të Kosovës.

### 2.3 Burimi i të dhënave

Burimet kryesore të të dhënave janë: Sistemi i Raportimit të Transaksioneve Ndërkombëtare (SRTN), Statistikat e Tregtisë së Jashtme (STJ), Anketat e Ndërmarrjeve (AN), dhe raportet nga institucionet qeveritare. Të dhënat janë të plotësuara me informatat e marra nga burimet tjera (UNMIK-u, EULEX-i dhe Donatorët) si dhe me vlerësimet e Drejtorisë së Statistikës të BQK-së.

### 2.4 Periodiciteti

Statistikat e BP-së kanë filluar të përpilohen dhe publikohen që nga viti 2006 duke përfshirë periudhën statistikore 2004-2005. Deri më 2009, duke përfshirë periudhën referuese 2004-2008 statistikat e BP-së janë publikuar në bazë vjetore. Nga viti 2009 statistikat e BP-së përpilohen dhe publikohen në bazë tremujore, konform standardeve ndërkombëtare.

## 3. Zërat specifik të BP-së

Dy klasifikimet kryesore të transaksioneve në pasqyrën e bilancit të pagesave janë (1) llogaria rrjedhëse, dhe (2) llogaria kapitale e financiare. Llogaria rrjedhëse paraqet transaksionet lidhur me mallrat, shërbimet, të hyrat dhe transferet rrjedhëse, ndërsa llogaria kapitale e financiare paraqet transaksionet lidhur me transferet kapitale, investimet direkte, investimet në letra me vlerë dhe në depozita/kredi, si dhe asetet rezervë.

### 3.1 Llogaria rrjedhëse

#### 3.1.1 Mallrat

Statistikat e tregtisë së jashtme, importi dhe eksporti i mallrave përpilohen bazuar në të dhënat e pranuar nga Dogana e Kosovës. Eksportet dhe importet e mallrave vlerësohen nga Dogana me çmimet e tregut në kufirin e vendit i cili eksporton mallrat. Për eksportet vlera e regjistruar statistikore është në bazën FOB (free on board), kurse për importet në bazën CIF (cost, insurance, freight). Vlera statistikore është e bazuar në vlerën doganore dhe janë të regjistruara në euro. Përpilimi i statistikave mbi mallrat e importuara sipas shteteve bëhet bazuar në shtetin e origjinës së mallit, ndërsa për mallrat e eksportuara përpilimi i bëhet bazuar në destinimin final. Në përputhje me parimet e përgjithshme të BP-së, ndryshimi i pronësisë përcakton ekzistencën dhe kohën e regjistrimit të transaksioneve ndërkombëtare në mallra. Inkorporimi i të dhënave mbi importin dhe eksportin e mallrave në BP kërkon disa korrigjime të të dhënave bazike që merren nga Dogana e Kosovës. Kjo më pastaj rezulton me dallimin në vlerën e paraqitur të importeve dhe eksporteve të paraqitura në BP dhe dhe STJ.

### 3.1.1.1 Dallimi në mes të statistikave në BP dhe STJ

Prodhues zyrtar i STJ-së në Kosovë është Enti i Statistikës së Kosovës. Këto të dhëna përpunohen dhe publikohen bazuar në Sistemin e Harmonizuar të Përshkrimeve dhe Kodeve të Mallrave (Harmonized Comodity Description and Coding System).

Sikurse të dhënat e BQK-së, ashtu edhe ato të përpiluara dhe publikuara nga ESK-ja, paraqesin statistikave për tregtinë ndërkombëtare të Kosovës për një periudhë të caktuar (muajore apo kumulative brenda vitit kalendarik). Këto statistika shërbejnë për qëllime të ndryshme dhe i përgjigjen nevojave të përdoruesve të ndryshëm. Për shembull, nëse analizohen këmbimet e një vendi me vendet tjera në mallra, shërbime, investime të huaja direkte, atëherë këto informata janë të raportuara në BP, ndërsa për informata më të detajuara që kanë të bëjnë vetëm me mallrat atëherë burim më i përshtatshëm është STJ.

Figura 1. Shembull i dallimit në të dhënat e publikuara në STJ dhe BP




Figura: 1 paraqet një shembull të dallimit të të dhënave të publikuara nga Enti Statistikor i Kosovës në STJ-së dhe të dhënat e publikuara në kuadër të BP nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës. Statistikat mbi eksportin të publikuara në kuadër të BP-së janë më të larta për shkak të korrigjimeve të bëra për mbulueshmëri kurse, të dhënat për importin të publikuara në BP janë më të ulëta, kryesisht për shkak të korrigjimeve të ashtuquajtura mbi sigurimin dhe transportin, apo siç njihet ndryshe dallimi CIF/FOB në vlerën e importeve.

Tabela 1 prezanton një listë më të detajizuar të natyrës së transaksioneve që rezultojnë në dallimin e vlerës së importeve dhe eksporteve në BP dhe STJ:

Tabela 1. Dallimet në mes të statistikave të BP-së dhe STJ-së

| Përshkrimi   | BP   | STJ  |
|--|--|--|
| Mallrat për përpunim   | Të përfshira si "mallrat për përpunim"   | Të përfshira   |
| Mallrat e "ri-importuara" pas përpunimit/riparimit                                     | Mallrave të "ri-importuar" i shtohet edhe "vlera e mallit" me rastin e eksportimit | Eksporti përfshinë vlerën e mallit të eksportuar kurse ri-importi përfshinë vetëm vlerën e shtuar pas përpunimit/riparimit |
| Riparimi në mallra   | Të përfshira si "riparimet në mallra"  | Të përfshira   |
| Mallrat e importuara nën procedurat me lirime doganore                                 | Të përfshira   | Nuk janë të përfshira  |
| Transaksionet në mallra që i nënshtrohen prokurimit në aeroport                        | Të përfshira   | Nuk janë të përfshira  |
| Eksportet/importet nga personat fizik për qëllime jo komerciale deri në vlerën 60 euro | Të përjashtuara, përfshihen si shërbime në pjesën "shërbimet e udhëtimit"          | Nuk janë të përfshira  |
| Importet nga KFOR, UNMIK, EULEX  | Nuk janë të përfshira  | Nuk janë të përfshira  |
| Eksportet për UNMIK-un dhe EULEX-in  | Të përjashtuara, përfshihen si shërbime në pjesën "shërbime të tjera biznesi"      | Nuk janë të përfshira  |
| Eksportet për KFOR-in  | Të përjashtuara, përfshihen si shërbime në pjesën "shërbimet qeveritare"           | Nuk janë të përfshira  |
| Malli transit  | Të përjashtuara, përfshihen si shërbime në pjesën "shërbime të tjera biznesi"      | Nuk janë të përfshira  |
| Mallra nga emigrantët  | Të përfshira   | Të përfshira   |
| Ndihmat  | Të përfshira   | Të përfshira pjesërisht, importet nën "procedurat me lirime doganore" nuk janë të përfshira                                |
| Mallrat që hyjnë ose dalin nga Kosova ilegalisht                                       | Nuk janë të përfshira  | Nuk janë të përfshira  |
| Energjia elektrike   | Të përfshira   | Të përfshira   |
| Transiti i energjisë elektrike   | Nuk janë të përfshira  | Nuk janë të përfshira  |
| Ari jomonetar  | Të përfshira   | Të përfshira   |
| Mallrat e humbura ose të shkatërruara  | Nuk janë të përfshira  | Nuk janë të përfshira  |

### 3.1.1.2 Korrigjimet në të dhënat bazike në kategorin e mallrave

Bazuar në BPM5, ekzistojnë katër lloje kryesore të korrigjimeve të STJ-së në mallra. Ato janë: korrigjimet për mbulueshmëri, korrigjimet për klasifikim, korrigjimet për kohë dhe korrigjimet në vlerësim.

- **Korrigjimet në mbulueshmëri:** kërkohet të bëhen kur statistikatat e tregtisë me jashtë që janë burim për përpilimin e komponentit 'mallrat sipas bilancit të pagesave' (a) përfshijnë disa lloje të mallrave të cilat, në fakt, nuk kanë ndërruar pronësinë dhe (b) nuk përfshijnë disa lloje të tjera të mallit, që në fakt, kanë ndërruar pronësinë ndërkombëtarisht. Në këtë kontekst Drejtoria e Statistikës në BQK bënë një mori të korrigjimeve, për mbulueshmëri meqë të dhënat nga ESK nuk përfshijnë (1) disa nga mallrat e importuara nën procedurat me lirime doganore si dhe (2) nuk përfshijnë importet e mallrave që i nënshtrohen prokurimit në aeroport nga transportuesit.
  - **Korrigjimet në klasifikim:** kërkohet të bëhen kur në të dhënat bazike disa transaksione mund të jenë jo adekuate për qëllim të bilancit të pagesave, të klasifikuara si transaksione në mallra. Korrigjimet janë të nevojshme për të përmirësuar klasifikimin jo adekuate. Kjo përfshin korrigjimin e vlerës së importeve për koston e transportit dhe sigurimit (CIF) të mallrave deri në kufi, për të kaluar në vlerën FOB. Këto vlera të zbritura nga komponenti i mallrave regjistrohen si importe të shërbimeve të transportit respektivisht shërbimeve të sigurimit.
  - **Korrigjimet në kohë:** kërkohet të bëhen për qëllime të bilancit të pagesave për rastet kur lëvizjet e mallrave janë regjistruar në të dhënat bazike në kohën e cila nuk korrespondon me ndryshimin e pronësisë. Mallrat zakonisht janë të regjistruara në statistikatat e jashtme tregtare kur ato kalojnë kufirin. Koha kur pronësia ndryshon mund të jetë e ndryshme nga momenti kur ato kalojnë kufirin. Për shembull, një eksportues nga Shqipëria eksporton mall në Kosovë në dhjetor 2009. Importuesi nga Kosova bëhet pronar i mallit në janar 2010 kur ai pranon dokumentet dhe bënë pagesën e mallit. Sipas manualit për bilancin e pagesave transaksionet duhet të regjistrohen në baza simetrike konsistent me regjistrimet e kryera në llogarinë financiare të bilancit të pagesave të secilit shtet. Për momentin, BQK nuk bënë ndonjë vlerësim për të korrigjuar importet apo eksportet për kohën e regjistrimit (timing).
- Korrigjimet në vlerësim:** kërkohet të bëhen kur mallrat nuk janë të vlerësuara sipas çmimeve të tregut. Për këtë arsye korrigjimi duhet të bëhet për të vlerësuar diferencën në mes të vlerës së regjistruar nga dogana dhe vlerës së mallit në treg. BQK bënë korrigjimin e mallit të ri-importuar dhe për këtë korrigjim më shumë informata janë dhënë në paragrafin "Mallra për përpunim".

Në kategorinë e mallrave të BP-së përfshihen këto nën kategori:

- mallrat e përgjithshëm;
- mallrat për përpunim;
- riparimet e mallrave;
- mallrat e blerë në porte; dhe
- ari jomonetar.

**Mallra të përgjithshëm:** (me disa përjashtime) përfshijnë mallra të lëvizshëm, pronësia e të cilëve kalon nga rezidentët kosovar tek jorezidentët, dhe anasjelltas. Në llogarinë e mallrave të përgjithshëm importet FOB janë të regjistruara në anën e debitit kurse eksportet FOB janë të regjistruara në anën kredit.

Vlerësimi i *importeve të përgjithshme* (Importet FOB) bëhet si vijon:

$$\text{Importet FOB} = \text{Importet sipas ESK} - \text{Mallrat për përpunim} - \text{Riparimet e mallrave} + \text{Mallrat me lirime doganore} - \text{Kosto e transportit dhe sigurimit të mallrave}$$

P.sh. Importet FOB për vitin 2008, të shprehura n milion euro, llogariten si vijon:

|   |                |
|---|----------------|
| Importet CIF (importet sipas ESK)                         | 1,928.2        |
| Korrigjimet për mbulueshmëri (Mallrat me lirime doganore) | + 37.5         |
| Korrigjimet për klasifikim (kalimi nga CIF në FOB)        | - 91.7         |
| Mallrat për përpunim (Importi i përkohshëm)               | - 26.5         |
| <u>Riparimet e mallrave (Ri-importet)</u>                 | <u>- 5.9</u>   |
| <b>Importet FOB</b>                                       | <b>1,841.6</b> |

Meqë vlerësimi i mallrave në BP bëhet në bazë të vlerës së tregut të mallit në kufirin e vendit eksportues (d.m.th. të shtetit që eksporton mallin), atëherë eksportet nuk ka nevojë të korigjohen prej asaj që është e regjistruar nga Dogana e Kosovës, pra merren si eksporte FOB. Korrigjimi për importet nga CIF në FOB bëhet duke përdorë koeficientët për të vlerësuar koston e transportit dhe sigurimit.


Raporti CIF/FOB gjendet pas zbritjes së importeve nga vendet fqinje (Shqipëria, Maqedonia, Serbia dhe Mali i Zi), për të cilat vlerësohen se janë importe FOB. Për të gjitha vendet e tjera, pa marrë parasysh distancën (se a është import nga Japonia apo nga Italia), zbatohet një koeficient i njëjtë për llogaritjen e vlerës së transportit dhe sigurimit të mallit.<sup>1</sup> Llogaritja e koston së transportit dhe koston së sigurimit të mallrave për vitin 2008 është bërë si vijon:

|                                   |                                      |
|-----------------------------------|--------------------------------------|
| Importet sipas ESK                | 1,928.2 milion euro                  |
| <u>Importet nga vendet fqinje</u> | <u>- 628.9 milion euro</u>           |
| Importet për korrigjim            | 1,299.3 milion euro                  |
| Kostoja e transportit të mallrave | = 1,299.3 x 5.56% = 72.2 milion euro |
| Kostoja e sigurimit të mallrave   | = 1,299.3 x 1.5% = 19.5 milion euro  |

<sup>1</sup> Shumica e vendeve bëjnë llogaritjen e raportit CIF/FOB duke përdorë koeficientët vlerësues. Disa nga këto vende aplikojnë përqindje të njëjtë për të gjitha shtetet pa marrë parasysh distancën (psh. Danimarka 3.7%, Spania 4.5%, Portugalia 4.67%, Qipro 10%, Hungaria 2.66%, Lituania 5.6%, Polonia 2.5%, Rumania 7.7%, Slovenia 3.93%, Turqia 6%. Vende të tjera përdorin Irlanda aplikon koeficientin 2% për vende të EU-së kurse 4.8% për vendet tjera; Italia i grumbullon vendet në 32 zona të ndryshme, Estonia deri në vitin 2002 ka përdorë koeficientin 5% për të gjithë partneret, pas kësaj periudhe raporti CIF/FOB llogaritet për secilin vend veças. Disa vende nuk bëjnë fare korrigjim të vlerës së importeve, siq janë Greqia, Republika e Çekisë.

**Mallra për përpunim:** mbulojnë mallrat që janë eksportuar ose importuar për përpunim mbi bazën e një kontrate dhe kundrejt një shpërblimi, mirëpo me këtë rast nuk ndodhë ndërrimi i pronësisë së mallit. Mallrat për përpunim duhet të regjistrohen në BP nëse mallrat e përpunuara do të kthehen në vendin e origjinës. Pra, ky proces përfshinë dy transaksione: së pari malli eksportohet për tu përpunuar jashtë vendi dhe pas përpunimit ri-importohet në vendin e origjinës. Një shembull i këtillë është eksporti i lëndëve të para dhe ri-importi i këtyre eksporteve pas përpunimit. Këto transaksione në mënyrë ilustrative mund të prezantohen si vijon:

**Figura 2. Shembull ilustrativ i transaksioneve lidhur me përpunimin e mallit jashtë vendi**



Regjistrimet në BP bëhen në bazën bruto, që nënkupton se vlera e mallit para dhe pas përpunimit regjistrohet.

**Figura 3. Regjistrimet në BP dhe në Dogana**

|  | Kosova  |          | Vendi X |        |
|--|---------|----------|---------|--------|
|  | Eksport | Import   | Eksport | Import |
| Eksport për përpunim (Regjimi EX2, proc. 21 00)      | 30      |          |         |        |
| Import për përpunim (Regjimi IM5, proc. 51 00)       |         |          |         | 30     |
| Ri-import pas përpunimit (Regjimi IM62, proc. 61 21) |         | 30+50=80 |         |        |
| Eksport pas përpunimit (Regjimi EX3, proc. 31 51)    |         |          | 80      |        |

Deri më 31 dhjetor 2009, regjistrimi në Doganat e Kosovës për ri-importet pas përpunimit ka përfshirë vetëm vlerën e shërbimeve të përpunimit (50) por jo edhe vlerën e mallit para se të përpunohet. Për këtë arsye, dhe me qëllim për të qenë konsistent me regjistrimet në vendet e tjera, Drejtoria e Statistikës bënte korrigjimin e vlerës së ri-importeve duke i shtuar vlerën e mallit para se të përpunohet.

Nga kategoria mallra për përpunim përjashtohen ato mallra që pas përpunimit nuk kthehen në vendin e origjinës. Këto mallra përfshihen nën zërin mallra të përgjithshëm. Pagesa për përpunimin për këto raste regjistrohet në debi të shërbimeve, ndërsa shifra e eksporteve korrigjohet me vlerën e përpunimit.

**Riparimet e mallrave:** mbulojnë aktivitetin e riparimeve që përfshin punën e kryer nga rezidentët mbi mallrat e lëvizshëm, që janë pronë e jorezidentëve (ose e anasjellta). Shembull i këtyre mallrave janë riparimet e lokomotivave, automjeteve transportuese,

anijeve, etj. Vlera e regjistruar është vlera e riparimit (e paguar apo e pranuar) dhe jo vlera e mallit para riparimit dhe pas riparimit.

Standardet ndërkombëtare rekomandojnë që vlera e të gjitha riparimeve të përfshihet në kuadër të kategorisë së mallrave. Përfshihen nga kjo kategori: riparimet e konstruksioneve (regjistrohen në shërbime konstruksionesh), riparimet e kompjuterave (regjistrohen në shërbime kompjuterash dhe informacioni), mirëmbajtja në porte dhe aeroporte e mjeteve të transportit (regjistrohet në shërbime transporti).

**Mallrat e blerë në porte:** përfshijnë mallrat siç janë karburantet për aeroplanë, ushqimet, rezervat e ndryshme të siguruar nga rezidentët kosovar jashtë dhe mallrat që jorezidentët marrin në Kosovë. Përfshihen nga ky zë shërbimet që lidhen me këto mallra të cilat duhet të regjistrohen në zërin shërbime të tjera transporti.

**Ari jomonetar:** nënkupton arin që nuk mbahet si aset rezervë nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës. Ari jo monetar, trajtohet si çdo lloj tjetër malli dhe kur është e mundur, ai ndahet në ar industrial dhe në ar stoli.

### 3.1.2 Shërbimet

Tregtia në shërbime paraqet provizionin e shërbimeve të rezidentëve ndaj jorezidentëve dhe anasjelltas. Komponenti i shërbimeve të BP-së përbëhet nga këto lloje të shpenzimeve:

- shërbime transporti;
- shërbime udhëtimi;
- shërbime komunikacioni;
- shërbime ndërtimi;
- shërbime sigurimi;
- shërbime financiare;
- shërbime kompjuteri dhe informacioni;
- drejta e autorit dhe licenca;
- shërbime të tjera biznesi
- shërbime personale, kulturore dhe argëtimi;
- shërbime qeveritare.

**3.1.2.1. Shërbime transporti:** është proces i bartjes së njerëzve dhe objekteve nga një lokacion në tjetrin duke përfshirë edhe shërbimet e lidhura ndihmëse dhe mbështetëse me procesin e bartjes. Transporti mund të klasifikohet sipas:

- (a) mënyrës së transportit (transporti detar, ajror hekurudhor, rrugor, gazësjetës, transporti i energjisë elektrike apo ndonjë lloj tjetër jo i specifikuar më lartë);
- (b) Asaj se çfarë është bartur që mund të jetë pasagjerë apo mallra.

Transporti i pasagjerëve vlerësohet në bazë të dhënave nga Anketat me agjencitë e kompanive fluturuese si dhe bazuar në të dhënat e SRTN-së. Vlera e shërbimeve për transportimin e mallrave caktohet duke u bazuar në ndryshimin në mes të vlerës së mallrave të importuara në CIF dhe FOB. (si debi). Raporti i transportit të mallrave kundrejt shumës totale të importeve CIF konsiderohet të jetë 5.6%. Marrja e provizioneve



dhe tarifave të agjentit për shërbimet e ndërlidhura të transportit si dhe tarifat e aeroportit për aterim regjistrohen si kredi;

**3.1.2.2. Shërbime udhëtimi:** përfshijnë shërbimet që u ofrohen jorezidentëve gjatë udhëtimeve në Kosovë (kredi), dhe shërbimet që u ofrohen rezidentëve të Kosovës gjatë udhëtimeve të ngjashme jashtë vendit (debi). Përjashtim bënë personeli ushtarak dhe diplomatik (p.sh. KFOR-i dhe Ambasadat), shpenzimet e të cilëve llogariten si shërbime qeveritare. Komponenti i shpenzimeve të udhëtimit në bilancin e pagesave mbulon dy nënkategori udhëtimesh: udhëtimet biznesore dhe udhëtimet personale.

- Udhëtimet biznesore përfshinë të gjitha llojet e udhëtimeve që kanë të bëjnë me aktivitetet e biznesit, udhëtimet zyrtare të punëtorëve të qeverisë, udhëtimet zyrtare të punëtorëve të organizatave ndërkombëtare (p.sh. asistencë teknike), dhe punëtorët e ndërmarrjeve që nuk janë rezidentë në atë ekonomi. Të dhënat për udhëtimet biznesore vlerësohen në bazë të informatave nga ndërmarrjet dhe të dhënave nga SRTN-ja.
- Udhëtimi personale përfshinë të gjitha shpenzimet e rezidentëve të Kosovës të cilët udhëtojnë jashtë vendi dhe kthehen në Kosovë por që nuk përfshihen në udhëtimet biznesore. Këtu gjithashtu përfshihen shpenzimet e akomodimit të stafit ndërkombëtar jorezident në Kosovë (në anën kredi) dhe shpenzimeve për udhëtim jashtë vendit të stafit ndërkombëtar rezidentë, (në anën debi). Supozohet se, stafi ndërkombëtar jorezidentë shpenzon rreth 14 % të pagës së tyre në Kosovë. Ky vlerësim është bërë duke u bazuar në një studim të Zyrës për Politika Ekonomike të ish-Shtyllës së 4-të të UNMIK-ut. Burim tjetër me rëndësi i informatës për udhëtimin personal është nxjerr nga Anketa e Buxhetit të Ekonomisë Familjare, lidhur me konsumin e diasporës kosovare gjatë vizitave të tyre në Kosovë. Vlerësimi i shpenzimeve të kosovarëve lidhur me udhëtimet për pushime jashahtë vendi është bërë duke i ndërthurur informatat nga bankat qendrore në rajon (Banka e Shqipërisë dhe Banka Qendrore e Malit të Zi), si dhe të dhëna tjera të siguruar përmes SRTN-së.

**3.1.2.3. Shërbime komunikacioni:** përmbledhin dy kategori kryesore të shërbimeve, e që janë: shërbime postare dhe shërbime telekomunikacionit. Në shërbimet postare përfshihen transaksionet (pranimet dhe pagesat) me jo rezidentët për marrjen, transportin, dhe shpërndarjen e letrave, gazetave, botimeve periodike, materialeve të tjera të printuara, pakove nga administratat kombëtare postare dhe operatorët e tjerë jashtë Kosovës/në Kosovë. Në shërbime telekomunikacionit përfshihen transaksionet me jo rezidentët për shërbimet në transmetimin e tingujve, imazheve, ose informacioneve të tjera përmes telefonit, satelitit, postës elektronike, etj., duke përfshirë internetin, shërbimet e rrjetit të punës dhe të përkrahjes.

Burim kryesor i informatave për shërbimet e komunikacionit janë informatat e marra direkt nga ndërmarrjet si dhe të dhënave nga SRTN-ja.

**3.1.2.4. Shërbime ndërtimi:** përfshin punën e kryer gjatë një projekti ndërtimi apo instalimi në Kosovë, brenda një viti nga një kompani jorezidente dhe anasjelltas. Këto projekte janë afatshkurtra, për të cilat rregulli 'më pak se një vit' aplikohet por me fleksibilitet. Periudha kohore e realizimit të këtyre projekteve i dallon këto shërbime nga investimet e huaja direkte. Kjo do të thotë që nëse kompania jorezidente realizon këtë shërbim për më pak se

një vit, atëherë të gjitha transaksionet e kryera nga kjo kompani trajtohen si shërbime ndërtimi, në të kundërtën konsiderohen si investime të huaja direkte. Mallrat, shërbimet dhe fuqia punëtore, të përdorura për të realizuar projekte gjithashtu përfshihen në shërbime ndërtimi. Të dhënat lidhur me shërbimet e konstruksionit merret nga raportimi tremujor i ndërmarrjeve si dhe nga raporti i SRTN-së.

**3.1.2.5. Shërbime sigurimi:** përfshijnë të gjitha llojet e sigurimit që kompanitë e sigurimit rezidente u kryejnë jorezidentëve dhe anasjelltas. Shërbimet e sigurimit mund të jenë: sigurim i mallrave që importohen ose eksportohen, lloje të tjera të sigurimit direkt (p.sh. sigurimi i jetës dhe fondet e pensionit, sigurimi shëndetsorë), dhe risigurime. Vlerësimi i sigurimit të mallrave bëhet sipas vlerësimit f.o.b. të vlerës së importeve. Kostoja e sigurimit deri në kufirin doganor të ekonomisë eksportuese përfshihet në vlerën f.o.b. të mallrave të eksportuar. Raporti i transportit të mallrave kundrejt shumës totale të importeve CIF konsiderohet të jetë 1.5%. Llojet e tjera të shërbimeve regjistrohen në bazën neto, që d.m.th. se vetëm nga vlera e totalit të primeve zbritet vlera e parashikuar e shërbimit dhe kërkesave të pagueshme, të cilat regjistrohet në transfertat rrjedhëse. Të dhënat për vlerësimin e shërbimeve të sigurimit merret nga Enti Statistikor i Kosovës, raportimi mujor i kompanive të sigurimeve dhe nga SRTN-ja.

**3.1.2.6. Shërbime financiare:** Përfshinë tarifat e paguar ndaj/pranuar nga jo rezidentët për shërbimet e ndërmjetësimit, si p.sh. dhënia hua, huaja financiare, letër-kreditë, pranimet bankare, linjat e kreditit, transaksionet e këmbimit të huaj dhe të çeqeve të udhëtarëve; ose që kanë të bëjnë me sigurimin në ndërmjetim, vendosja e plasmaneve, nënshkrimet, riblerja, kundër-këmbimi valutor, kontrata me zgjedhje (opsioni), dhe mallrat e pritshme; si dhe portofoli dhe tarifat e tjera të menaxhmentit

**3.1.2.6. Shërbime kompjuteri dhe informacioni:** përfshinë provizionin e paguar apo pranuar nga jorezidentët lidhur me shërbimet kompjuterike, shërbimet e agjensive të lajmeve dhe lloje të tjera të shërbimeve të informimit. Shembuj të këtyre shërbimeve janë pagesat për zhvillimin e bazës së të dhënave, ruajtjen, shërbimeve 'on-line' të serive kohore, procesimin e të dhënave, hedhjen në tabela; projektimin e software-it, zhvillimin, zbatimin, programimin; konsulencën mbi pjesët elektronike; riparimin, mirëmbajtjen e pajisjeve kompjuterike/periferike edhe shërbime të tjera të ngjajshme.

**3.1.2.6. E drejta e autorit dhe licenca:** përfshinë tarifat e paguara ndaj/pranuara nga jo-rezidentët për shfrytëzimin e autorizuar të mjeteve të paprekshme, jo-prodhuese (non-produced), jofinanciare dhe të të drejtave të autorit (përfshirë patentat, proceset industriale dhe të krijimtarisë). Në anën tjetër, shitja e tërsishme e të drejtave të pronësisë është e trajtuar si shitje e mjeteve jo prodhuese, jofinanciare dhe regjistrohet në llogarinë kapitale të BP-së. Shembuj të transaksioneve në këtë kategori janë tarifat e paguara ndaj/pranuara nga jo-rezidentët për përdorimin e autorizuar të patentave, të drejtave të autorit, markës, eskuzivitetit, etj. dhe për liçensimin e marrëveshjeve që kanë të bëjnë me dorëshkrimet, pikturat, skulpturat, etj.

**3.1.2.6. Shërbime të tjera biznesi:** janë të përbëra nga një mori e shërbimeve përfshirë shërbimet që kanë të bëjnë me ndërmjetësimin e mallrave dhe shitjen në ankand, shërbimet e qirasë, dhe shërbime tjera biznesi, profesionale e teknike jo të përfshira më lartë.

**3.1.2.6. Shërbime personale, kulturore dhe argëtimi:** janë të ndara në audio-vizuale dhe shërbime të tjera kulturore. Kategoria e parë përfshinë tarifat paguar ndaj aktorëve, regjisorëve dhe producentëve jo-rezidentë (ose pranuar nga rezidentët) që merren me

produksionin e filmave kinematografikë dhe televizivë; të drejtat e shpërndarjes së kasetave dhe të radios shitur ndaj medias; dhe kategoria e dytë përfshinë të gjitha shërbimet e tjera personale, të rekreacionit përfshirë ato të lidhura me muzeumet, libraritë, arkivat, dhe provizionet e korrespondencave për kurse të mbajtura nga profesorët ose doktorët.

**3.1.2.1.1 Shërbimet qeveritare:** përfshinë të gjitha transaksionet nga ambasadat, konsullatat, organizatat ndërkombëtare, njësitë ushtarake, dhe agjensionet e mbrojtjes me stafin rezident ose personelin ushtarak në ekonomitë në të cilat ato janë të vendosura. Kështu në anën e kredisë në BP janë të regjistruara të gjitha transaksionet me ambasadate huaj në Kosovë dhe eksporti i mallrave e shërbimeve për KFOR-in. Burimet e të dhënave janë të ndryshme si: SRTN-ja, Ambasadat, Komunat si dhe të dhënat nga UNMIK-u respektivisht EULEX-i.

### 3.1.3 Të ardhurat

Komponenti i të ardhurave ndërlidhet me të ardhurat e fituara nga dy faktorë të prodhimit: puna dhe kapitali. Si rrjedhojë, të ardhurat përbëhen nga (i) kompensimi i punonjësve dhe (ii) të ardhurat nga investimet.

#### 3.1.3.1 Kompensimi i punonjësve

Kompensimi i punonjësve përfshinë pagat, mëditjet dhe beneficionet e tjera të paguara për punëtorët jorezident në vend, apo të pranuar nga punëtorët rezident jashtë vendit. Në këtë kontekst, përfshinë punëtorët sezonal apo punëtorët tjerë afatshkurtër (më pak se një vit) dhe punëtorët kufitar të cilët qendrën e interesit ekonomik e kanë në ekonominë e tyre. Kompensimi i punonjësve i paguar nga organizatat ndërkombëtare dhe KFOR-in për kosovarët që punojnë në këto organizata, janë të regjistruara në anën e kredisë (me përjashtim të punonjësve vendor që punojnë për UNMIK-un/EULEX-in, të cilët regjistrohen në kuadër të transfereve rrjedhëse). Kompensimi i punonjësve kalkulohet duke u bazuar në burime të ndryshme të informatave, përfshirë të dhënat e mbledhura drejtpërdrejt nga UNMIK-u/EULEX-i, KFOR-i, MEF-i, Ambasadat, dhe nga organizatat e tjera ndërkombëtare;

#### 3.1.3.2 Të ardhurat nga investimet

Të ardhurat nga investimet mbulojnë pranimet dhe pagesat e të ardhurave të shoqëruara nga mjetet e jashtme financiare dhe detyrimet. Komponenti kryesor i të ardhurave nga investimet përfaqëson të ardhurat nga investimet direkte, investimet portofoli dhe investimet e tjera. Forma më tipike e të ardhurave nga jashtë është interesi i fituar nga depozitat apo letrat me vlerë në bankat e huaja. Në anën e 'debi' janë të përfshira pagesat për investitorët direkt në Kosovë si: dividendët, fitimi i ri-investuar, pagesa e kamatës për huamarrjet nga jashtë, etj., kurse në anën 'kredi' janë të përfshira arkëtimet nga investimet direkte jashtë vendi. Burimet kryesore të informatave mbi të hyrat nga investimet janë BQK-ja, bankat komerciale, kompanitë e sigurimit, Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës, dhe SRTN-ja;

#### 3.1.4 Transferet rrjedhëse

Transferet janë ndihma materiale e financiare që një vend përfiton nga një tjetër, me ç'rast njëra palë i jep një vlerë ekonomike palës tjetër, por nuk merr si kthim një vlerë të njëjtë. Transferet mund të jenë në formë të mjeteve financiare, ose të mallërave dhe shërbimeve të

ofruara. Transferet janë të identifikuara ndaras si transfere rrjedhëse ose kapitale. Transferet rrjedhëse janë të përfshirë në llogarinë rrjedhëse të bilancit të pagesave kurse transferët kapitale në llogarinë kapitale. Ndarja e transfereve në këto dy kategori është e nevojshme për të harmonizuar bilancin e pagesave me llogaritë kombëtare. Transferet rrjedhëse afektojnë në mënyrë direkte shkallën e të ardhurave në dispozicion (disposable income) dhe duhet të influencojnë konsumin e mallrave ose shërbimeve. Transferet kapitale janë transferimi i pronësisë së një mjeti fiks ose një borxhi të falur. Zakonisht janë në vlera të mëdha dhe të pa rregullt (shih transferet kapitale më poshtë). Transferet rrjedhëse ndahen në dy lloje kryesore: (1) transferet qeveritare dhe transferet e sektorëve tjerë.

#### **3.1.4.1 Transferet rrjedhëse te sektorit qeveritarë**

Transferet qeveritare përfshijnë ndihmat shtetërore nga jashtë. Shembull i transfereve rrjedhëse të sektorit qeveritarë janë ndihmat në formë të asistencës teknike (grantet, ndihma e donatorëve, dhe shpenzimet e drejtëpërdrejta të UNMIK-ut/EULEX-it). Burimet kryesore të të dhënave për vlerësimin e transfertave rrjedhëse te sektorit qeveritarë në Kosovë janë Agjencia për Koordinimin e Zhvillimit dhe Integrimin Evropian (Zyra e Kryeministrit), institucionet e tjera qeveritare, UNMIK-u, EULEX-i dhe raporti i SRTN-së.

#### **3.1.4.2 Transferet rrjedhëse të sektorëve tjerë**


Transferet e sektorëve tjerë përfshijnë ndihmat për sektorin jo qeveritar. Transferet rrjedhëse të sektorëve të tjerë më tej ndahen në dy nëngrupe kryesore: (1) dërgesat e emigrantëve (remitancat) dhe (2) transferet tjerë.

Meqenëse dërgesat e emigrantëve në Kosovë paraqesin një ndër zërat kryesor në kuadër të transferave, një vështrim i posaçëm është bërë mbi metodikën e përpilimit të statistikave mbi remitancat.

Remitancat e punëtorëve përfshijnë transferet rrjedhëse nga emigrantët të cilët janë të punësuar në ekonomitë e tjera dhe konsiderohen rezident atje. Emigranti është personi i cili vjen në një ekonomi dhe qëndron për një vit apo më tepër. Personat të cilët qëndrojnë në ekonomi të reja për më pak se një vit, konsiderohen jorezident; transaksionet e tyre janë të përshtatshme kryesisht për komponentin e kompensimit të punonjësve.

Vlerësimi i të hyrave nga remitancat është bërë duke u bazuar në kanalet kyçe të rrjedhjes së tyre. Një varietet i burimeve të të dhënave është përdorur për matjen e fluksit hyrës të remitancave. Fokus i veçantë i është dhënë identifikimit të remitancave nga kanalet institucionale (bankat, agjensitë për transferin e mjeteve, dhe paratë e deklaruara pikat kufitare) dhe remitancat që vijnë përmes kanaleve jo institucionale (paraja e gatshme e padekluarur në pikat kufitare, dhe remitancat në mallra nga emigrantët që jetojnë jashtë Kosovës. Skema e përpilimit të remitancave që hyjnë në Kosovë (anën e kredisë ) është paraqitur më poshtë:

Figura 3. Kanalet e remitancave



Në anën e debisë së komponentit të BP remitancat, përfshihen dërgesat e stafit ndërkombëtar rezidentë në Kosovë. Vlerësohet se të ardhurat e stafit ndërkombëtar dedikuar të afërmve të tyre janë 76% nga pagart e tyre. Burimet e të dhënave për punëtorët e huaj rezidentë të Kosovës janë buxheti i UNMIK-ut/EULEX-it dhe Agjencia për Koordinimin e Zhvillimit dhe Integrimin Evropian (Zyra e Kryeministrit).

Transferet tjerë rrjedhëse, në para të gatshme ose në mallra, përfshijnë tatimet në të ardhura, pasuri, etj, dhe transferet e tjerë si psh. kontribute dhënë për qëllime fetare, primet dhe pretendimet për shërbimet e sigurimit jojetësore neto, kontributet dhe pensionet, bursat dhe ndihmat e tjera të ngjashme për trajnimin praktik përfituar nga qeveritë e huaja, dhe pagesa ose pranime të tjera jo të përfshira më lartë nga ekonomitë familiare.

Burimet kryesore të të dhënave për vlerësimin e transfertave të sektorëve jo qeveritarë janë raporti i SRTN-së, të dhënat e tjera nga bankat, dogana e Kosovës, Anketa mbi Buxhetin Familjar (e zbatuar nga ESK-ja) si dhe nga burime të tjera.

## 3.2. Llogaria kapitale dhe financiare e BP-së

Llogaria kapitale dhe financiare e BP-së është e ndarë në dy kategori kryesore: llogarinë kapitale dhe llogarinë financiare.

### 3.2.1 Llogaria kapitale

Llogaria kapitale regjistron të gjitha transaksionet që involvojnë pranimet ose pagesat e (1) transfertave kapitale dhe (2) transaksionet në mjetet jo prodhuese - jo financiare (siç janë patentat, dhe të drejtat e autorit). Edhe transferet kapitale, ngjajshëm sikurse transferet rrjedhëse, ndahen në dy kategori kryesore: në transfere qeveritare (p.sh. borxhi i jashtëm) dhe transfere të sektorëve tjerë (joqeveritare).

#### 3.2.1.1 Transferet kapitale

Transferet kapitale janë të lidhur me transferimin e pronësisë së një mjeti fiks, ose faljes së një detyrimi nga kreditori, pa kundërshtëpërbllim. Më tutje transferet kapitale ndahen në (1) falje e borxhit, (2) transfere të migrantëve dhe (3) transfere të tjerë. Falja e borxhit është e definuar si fshirje vullnetare e borxhit në mes të një kreditori dhe një debitori nga një vend

tjetër. Transferet e migrantëve përfshijnë vlerën neto të pasurisë me rastin e shpërnguljes së emigrantëve nga një vend në vendin tjetër.

### 3.2.1.2 Përvetësimi/asgjësimi i mjeteve jo prodhuese – jofinanciare

Kjo kategori përfshin mjetet jo materiale siç janë patentat, të drejtat e autorit, e drejta e shitjes (franshiza), e drejta mbi kontratën e qerasë dhe kontrata të tjera të transferueshme, gudvillin, si dhe transaksionet e tjera që involvojnë mjetet fikse që mund të përdoren për prodhimin e mallrave dhe shërbim mirpo ato vetë nuk janë prodhuar (p.sh toka). Burimet kryesore të të dhënave për vlerësimin e transfertave kapitale janë raporti i SRTN-së, të dhënat nga KFOR-i, si dhe vlerësime nga burime të tjera të ndryshme të identifikuara nga DS i BQK-së.

**3.2.2 Llogaria financiare** përfshinë transaksionet në mjetet e jashtme financiare (kërkesat ndaj jorezidentëve) dhe detyrimet e huaja financiare (detyrimet ndaj jorezidentëve). Të katër kategoritë (investimet direkte, investimet në letra me vlerë, investimet tjera dhe mjetet rezerve), bazohen kryesisht në marrëdhënien në mes të palëve, dhe së dyti mbi natyrën e instrumentit të përfshirë.

#### 3.2.2.1 Investimet direkte

Investimet direkte janë kategori e investimeve ndërkombëtare që, bazuar në pronësinë e të paktën 10% të aksioneve, reflekton interesin e përhershëm nga rezidenti në një ekonomi (investuesi direkt) në ndërmarrjen rezidente në një ekonomi tjetër (ndërmarrja investuese direkte). Duke përdorur këtë kriter, marrëdhënia direkte e investimit mund të ekzistojë në mesin e një numri të ndërmarrjeve të bashkuara, pavarësisht nëse lidhja përfshin një varg zinxhiror të vetëm apo një numër të vargjeve zinxhimore. Komponentët e transaksioneve të investimit direkt janë:

Kapitali aksionar – përfshinë investimet në kompanitë ëmë – bijë, aksionet në nëndegë dhe ortakër (përveç aksioneve të preferuara jo participuese që trajtohen si letra me vlerë të borxhit), dhe kontributet e tjera të kapitalit;

Fitimi i riinvestuar - përbëhet nga të hyrat e kompensuara për llogarinë rrjedhëse korresponduese të mjetit të hyrave: është pjesa e investitorit direkt e fitimit të pashpërndarë të degëve të tyre, nëndegëve dhe ortakëve;

Kapitali tjetër - mbulon të gjitha transaksionet financiare ndërmjet degëve (huamarrjen dhe huadhënien e fondeve), përfshirë letrat me vlerë të borxhit dhe kreditë tregtare.

Fluksi i investimeve direkte regjistrohet në baza të drejtimit (më saktë në bazë të pasurive/detyrimeve): investimi direkt jashtë vendit - si mjet, dhe investimi direkt në vendin raportues - si detyrim. Investimi direkt jashtë vendit mbulon investimet neto nga ndërmarrjet amë rezidente të Kosovës, në filjalat e huaja, nëndegët dhe kompanitë e lidhura. Investimi direkt në Kosovë përfshinë investimet neto nga kompanitë e huaja në filialat e tyre të vendosura në Kosovë. BQK-ja përdor burime të ndryshme të informatave për kalkulimin e IHD-ve. Burimi kyç i informacionit për vlerësimin e IHD-ve në Kosovë është Agjencioni Kosovar i Privatizimit (AKP), raportet e bankave komerciale për BQK-në (SRTN) dhe Anketat e ndërmarrjeve.

### 3.2.2.2 Investimet portofolio

Kjo kategori mbulon përvetësimin dhe dispozicionin e ekuitetit dhe letrave me vlerë të borxhit, të cilat nuk mund të klasifikohen në kuadër të transaksioneve të investimeve direkte apo të mjeteve rezerve. Letrat me vlerë të përfshira janë të tregtuara (apo të tregtueshme) në tregjet e organizuara dhe tregjet e tjera financiare. Letrat me vlerë të borxhit përfshijnë bonat dhe dëftesat, që përmbajnë afat të kohëzgjatjes më shumë se një vit dhe instrumentet e tregut të parasë me kohëzgjatje prej një viti apo me pak. Të dhënat mbi letrat me vlerë të borxhit, në rastin e Kosovës, përfshijnë investimet në letrat me vlerë jashtë nga BQK-ja dhe bankat komerciale. Burimi kryesor i informatave mbi portofolin e investimeve janë të dhëna të siguruar nga BQK-ja dhe bankat komerciale që operojnë në Kosovë dhe fondet pensionale.

### 3.2.2.3 Investimet tjera

Investimet tjera mbulojnë mjetet dhe detyrimet tjera nga ato të klasifikuara për investimet direkte, investimet portofolio apo mjetet rezervë. Investimet tjera, përfshijnë huadhëniet afatshkurta dhe afatgjata, valutën dhe depozitat, kreditë tregtare, mjetet dhe detyrimet tjera. Kreditë tregtare afatshkurta përfshijnë parapagesat nga jorezidentët për eksportet e ardhshme (në anën e detyrimeve) dhe pagesat e pritura të vonuara për eksport nga ana e jorezidentëve (në anën e pasurive). Vlerësimi i kredive tregtare është bërë duke përdorur proporcionin e këtyre dy kategorive tek gjithsej importet dhe eksportet raportuara në SRTN. Informata lidhur me valutën dhe depozitat, huadhëniet dhe mjetet e tjera janë siguruar nga bilanci i gjendjes i bankave komerciale, bilanci i gjendjes i BQK-së, MEF-it (depozitat qeveritare jashtë), bilanci i gjendjes i institucioneve tjera financiare, SRTN-ja (depozitat dhe huadhëniet e entiteteve jo-financiare me jashtë) dhe anaketat e ndërmarrjeve (llogari tjera të pagueshme/arkëtueshme).

### 3.2.2.4 Asetet rezervë

Asetet rezervë përbëhen nga ato asete të jashtme të cilat janë të kontrolluara nga autoritetet monetare dhe janë të gatshme për financim direkt të imbalancave të pagesave ndërkombëtare, për rregullimin indirekt të madhësisë së deficitit të tillë përmes intervenimit në tregjet e këmbimit valutor për të influencuar normën e këmbimit valutor dhe/ose për qëllime të tjera. Asetet rezervë përbëhen nga:

Ari monetar,

Të Drejtat Speciale të Tirazhit (DST),

Pozicioni i rezervave në Fond,

Valuta e jashtme,

Kërkesat tjera.

Në rastin e Kosovës, asetet rezervë përbëhen nga DST-të (anglisht SDR), pozicioni i rezervave në FMN, dhe nga kërkesat ndaj jorezidentëve (në valutën euro). Prandaj, asetet rezervë janë të përbëra nga kërkesat e BQK-së ndaj jorezidentëve në formë të parasë së gatshme në BQK, depozitave të BQK-së të investuara jashtë Kosovës, si dhe letrave me vlerë. Kjo përbënë konceptin bruto të rezervave ndërkombëtare. Më pastaj kësaj shume i zbritet vlera e depozitave të Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe vlera e Fondeve Pensionale në BQK.



### 3.3 Gabimet dhe harresat neto

Teoritikisht, shuma e të hyrave në anën e kredisë, duhet të barazojë shumën e të hyrave në anën e debisë përgjat periudhës. Në praktikë, meqë disa transaksione mund të mos përfshihen apo për shkak të diferencës në mbulueshmëri, vlerësimi dhe koha e transaksioneve, nuk paraqet simetri ekzakte dhe zëri balancues i gabimeve dhe harresave neto shfaqet për të balancuar llogarinë e përgjithëshme. Madhësia e këtij zëri duhet të jetë relativisht e vogël në raport me vlerën e kombinuar të të gjitha transaksioneve në kredi dhe debi të shprehura në terma absolut.

## 4. Bilanci i pagesave dhe pozicioni ndërkombëtar i investimeve

Ekziston një ndërlidhshmëri në mes të BP-së dhe Pozicionit Ndërkombëtar të Investimeve (PNI). BP vlerësohet nga transaksionet që rrjedhin gjatë një periudhe të caktuar kohore, dhe përshtin të dhëna jo kumulative. Në anën tjetër, PNI, bënë vlerësimin e gjendjes kumulative, meqë regjistron gjendjen në fund të një periudhe të caktuar kohore të mjeteve dhe detyrimet të jashtme financiare, të një vendi përkatës. Gjendja në fund të periudhës është rezultat i gjithë transaksioneve që rrjedhin nga e kaluara plus korigjimet siq janë lëvizjet në kursin e këmbimit për të llogaritur vlerën e mjeteve/detyrimeve financiare në ditën e raportimit apo ndryshimet në çmimin e tregut. Tabela 1 tregon ndërlidhshmërinë në mes të BP-së dhe PNI-së.

Tabela 2. Bilanci i pagesave dhe pozicioni ndërkombëtar i investimeve

|                                      |                                  | Bilanci i Pagesave                     |                    |                                  |                       |                                  |               |
|--------------------------------------|----------------------------------|--|--------------------|----------------------------------|-----------------------|----------------------------------|---------------|
|                                      |                                  | Llogaria Rrjedhëse                     |                    |                                  |                       |                                  |               |
|                                      |                                  | Llogaria Kapitale                      |                    |                                  |                       |                                  |               |
| Pozicioni Ndërkombëtar i Investimeve | Pozicioni në fillim të periudhës | Transaksionet e Llogarisë Financiare + | Ndryshme në çmim + | Ndryshime në kursin e këmbimit + | Rregullime të tjera + | Pozicioni në fund të periudhës = |               |
|                                      | Mjetet                           | 150                                    | -15                | 7                                | -2                    | 1                                | 141 Mjetet    |
|                                      | Detyrimet                        | 100                                    | 5                  | -                                | 4                     | -2                               | 107 Detyrimet |
|                                      | PNI Neto                         | 50                                     | -20                | 7                                | -6                    | 3                                | 34 PNI Neto   |
|                                      |                                  | Gabime dhe harresa neto                |                    |                                  |                       |                                  |               |

Përveç ndryshimeve të natyrës së transaksioneve, BP dhe PNI dallon për shkak të disa ndryshimeve të tjera të cilat regjistrohen vetëm në kuadër të PNI-së. Transaksionet financiare mund të ndodhin për shkak të rritjes/zvogëlimit në mjeteve/detyrimeve, fitimit/humbjes në mjete/detyrime (psh nga interesi nga investimet) apo shpërndarje e dividendës. Ndryshimet e



tjera në zërat financiarë mund të ndodhin për shkak të ndryshimit në çmime të tregut, ndryshimit në normën e këmbimit si dhe rregullimeve të tjera. Ndryshimet në çmim janë ndryshime në vlerësim që ndodhin për shkak të ndryshimeve të çmimit të tregut të instrumentit financiar, siç janë ndryshimi në çmimin e aksionit apo letrave me vlerë të borxhit, ose për shkak të ri-vlerësimit të vlerës së kapitalit të kompanisë. Ndryshimet në normën e këmbimit janë për shkak të ndryshimit në vlerën e euros, në të cilën janë të përpiluara llogaritë, në relacion me valutat në të cilat mjetet dhe detyrimet janë denominuar. Rregullimet e tjera mund të ndodhin si pasojë e një numri të shkaktarëve siç janë shlyerja e borxhit të keq, ndryshimet për klasifikim, monetizimi/demonetizimi i arit, dhe alokimi/fshirja e DST-ve.